

VENDIM
Nr. 883, datë 27.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 244, DATË 30.3.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË ZBATOHEN
NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E PRODHIMIT, TRANSMETIMIT,
SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin që i bashkëlidhet vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e dytë, e pikës 2, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sasia dhe çmimi për njësi e energjisë elektrike, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të furnizuesit të shërbimit universal, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Prodhimit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata TIP, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguruar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit.

Furnizuesi i shërbimit universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, sipas vlerës së përcaktuar në kontratë, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Prodhimit.”.

2. Fjalja e parë, e pikës 3, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në rastet kur furnizuesi i shërbimit universal nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 2, të këtij neni, furnizuesi i shërbimit universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë me anë të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, me të njëjtin çmim që kjo energji prokurohet në treg të parregulluar. Në rast të mossigurimit të energjisë së nevojshme nga furnizuesi i tregut të lirë, furnizuesi i shërbimit universal mund ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë.”.

3. Pika 2, e nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Kontratat ekzistuese që OSHEE, sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike do të transferohen te furnizuesi i tregut të lirë, bazuar në aktet e brendshme ligjore/administrative ndërmjet shoqërive.”.

4. Pas pikës 2, të nenit 11, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të

shitblerjes së energjisë. Në rast të tepricave të krijuara ato do të tregtohen në treg të parregulluar me çmimin që ofron ky treg në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë.

4. Mungesat e mosplotësimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga energjia e burimeve të rinovueshme do të sigurohen nga shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë në treg, me çmimet e tregut në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë. Në rast të mossigurimit të energjisë së nevojshme nga furnizuesi i tregut të lirë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë.”.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama